



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

ZYRA E ADMINISTRIMIT TE  
BASENIT UJOR  
SHKUMBIN-SEMAN  
Nr. 773 Prot.  
Datë, më 13.06.2022

VENDIM

Nr.2, datë 06.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË  
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM  
HIDROENERGJETIK, ME NR.61/2 PROT., DATË 16.10.2017  
DHËNË NGA KBU SHKUMBIN, SUBJEKTIT "GEGA-G"**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, me nr. 61/2 prot., datë 16.10.2017 dhënë me vendim nr.55 datë 10.10.2017 nga KBU Shkumbin, subjektit "Gega-G", me adresë Njësia Administrative Lunik Librazhd Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC Prevalli**

Vepra e marrjes

- $X = 525343.7$ ;  $Y = 4578444.5$ ;  $Z = 690$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare  $Q_{mes} - 0.89$  m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike  $Q_{eko} - 0.15$  m<sup>3</sup>/s
- Sasia e ujit që jepet në përdorim  $Q - 0.89$  m<sup>3</sup>/s

Godina e Centralit

- X = 524990.1; Y = 4574941.3; Z = 471 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**MAJLINDA PERRIU**

